



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

**Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/320
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I33-2 Prot.

Tiranë 10/12/2025

Nr. Dok. 202502679/

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i domosdoshëm i kushteve për trajtimin e pacientëve në Spitalin Psikiatrik "Sadik Dinçi", Elbasan.*

Drejtuar: **Drejtorisë së Përgjithshme të Operatorit të Shërbimeve të
Kujdesit Shëndetësor**

TIRANË

Spitalit Psikiatrik "Sadik Dinçi"

ELBASAN

Për dijeni : Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

TIRANË

Të nderuar,

Avokati i Popullit, vlerëson bashkëpunimin e deritanishëm dhe angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona. Në vijim po ju njohim mbi inspektimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në institucionin tuaj në datë 24.04.2025.

Inspektimi u krye nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenit 31 të ligjit nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", i ndryshuar. Inspektimi u krye sipas Planit të

Inspektimit për vitin 2025 të miratuar nga Avokati i Popullit, me qëllim vlerësimin e progresit të bërë që nga vizita e fundit e MKPT-së në vitin 2024.

Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe z. Vullnet Topalli, me detyrë ndihmës komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar të institucionit të Avokatit të Popullit.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Institucioni i Avokatit të Popullit ka detyrimin ligjor t'ju parashtojë gjetjet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime paraprahe

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e MKPT-së në Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” në Elbasan, për vitin 2025. Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi monitorues fillimisht u takua me drejtorin e këtij institucioni z. Zenun Bullari, për ta informuar mbi qëllimin e monitorimit dhe për të mbledhur informacionet e nevojshme zyrtare.

Më tej, grupi i inspektimit vizitoi ambientet e këtij shërbimi. Nga inspektimi në vend, kontakti me stafin dhe pacientët, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, grupi inspektues grumbulloi informacion në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e pacientëve, respektimin e të drejtave të tyre, si dhe me problematikat e ndeshura gjatë punës.

Nga informacioni, rezultoi se kishin gjetur zbatim vetëm një prej rekomandimeve të Avokatit të Popullit¹ në inspektimin e mëparshëm e në fakt edhe më i rëndësishmi në përfitimin strukturor:

- Ishin marrë masa për realizimin e rikonstruksionit të plotë të godinës së Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi”, në Elbasan, sipas çeljes së buxhetit për vitet 2024-2026, për këtë institucion.

Ndërkohë një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit **nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar**. Më konkretisht:

- Nuk ishin marrë masa nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për pajisjen me Autoambulancë brenda vitit 2024.
- Nuk ishin marrë masa nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për sigurimin e pajisjeve në kabinetin stomatologjik brenda vitit 2024.

¹ Rekomandim Nr. K4/I23-2-2 Prot, datë 28.06.2024, “Për përmirësimin e kushteve për trajtimin e pacientëve në Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi”, Elbasan.

- Nuk ishin marrë masa nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për sigurimin e një Laboratori klinik bio-kimik. brenda vitit 2024.
- Nuk ishin marrë masat nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për shtimin në organikën e këtij institucioni të numrit të mjekëve psikiatër, infermierëve, kujdestarëve, punonjës pastrimi, berber dhe një punonjësi për mirëmbajtjen, në përputhje me nevojat për trajtim të pacientëve në shërbim të shëndetit mendor me shtretër, sipas konstatimeve në vijimësi të Institucionit të Avokatit të Popullit brenda vitit 2024.

Avokati i Popullit vlerëson se këto masa duhet të pasojnë rikonstruksion e plotë të këtij spitali.

Drejtori i Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi” në Elbasan, na informoi në lidhje me realizimin e rikonstruksionit të plotë të godinës dhe me shkresë nr.prot.704/1, datë 07.02.2024, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ishte përcaktuar fondi limit për kryerjen e këtij investimi të ndarë në tre zëra përgjatë dy viteve 2024-2026 përkatësisht:

- Rikonstruksioni i Spitalit Psikiatrik Elbasan
- Supervizim dhe kolaudim për rikonstruksionin e Spitalit Psikiatrik Elbasan
- Pajisje hotelerie dhe industriale për Spitalin Psikiatrik Elbasan

Avokati i Popullit ka evidentuar dhe rekomanduar ndër vite nevojat emergjente për ndërhyrje dhe rikonstruksion të plotë të kësaj godine dhe gjejmë rastin të shprehim kënaqësinë që më në fund rekomandimet tona janë marrë parasysh.

Nga komunikimi me Drejtorin e Spitalit jemi informuar se Universiteti Politeknik i Tiranës ka hartuar projektin për shërbimin "Hartimi i projektit për ndërtimin e godinave të reja në Spitalin Psikiatrik Elbasan", projekti ka parashikuar që do të ndërtohen dhe godina të reja dhe rikonstruksioni do të bëhet me faza, në fillim do të ndërtohen godinat e reja të cilat do të shërbejnë për akomodimin e pacientëve, për të vazhduar më tej me rikonstruksionin e spitalit. Ndërkohë është shpallur Fituesi “METEO” shpk & “ALBA KONSTRUKSION” dhe pritët të fillojë puna.

Projekti i godinave të reja dhe godinave ekzistuese në spitalin psikiatrik “Sadik Dinci” parashikohet të ketë karakteristikat e mëposhtme:

Pas vlerësimit paraprak të situatës ekzistuese dhe kërkesave të paraqitura nga detyra e projektimit është vlerësuar nevoja se struktura e spitalit Sadik Dinci ka nevojë për zgjerim të hapësirave funksionale me godina të reja. Ky zgjerim hapësirash konsiston në ndërtimin e një godine të re për klinikat kronike të pacienteve femra dhe një godine për administratën në krahun perëndimor të territorit. Kjo do të bëjë të mundur krijimin e më shumë hapësirave dhe në godinën ekzistuese pasi lëvizja e administratës liron hapësira për krijimin e ambienteve për stafin teknik dhe vendosjen e laboratorit. Rritja e standardit dhe cilësisë në kushtet e

strehimit dhe jetesës brenda spitalit do të përfshijë dhe godinën ekzistuese, ku është parashikuar ulja e numrit të pacienteve në dhoma.

Në godinën e re ku do të vendosen 2 klinikat kronike për gra janë parashikuar dy lloje dhomash, me 2 dhe 4 paciente. Dhe për secilin model varianti me tualete brenda dhomave po ashtu edhe me tualete të përbashkëta. Edhe në rikonstruksionin e godinës ekzistuese janë parashikuar dhoma 2, 3 dhe për 4 persona.

- Godina femra: Në katin përdhe do të jenë 5 dhoma me 4 paciente/dhome (nga këto 2 dhoma me tualete brenda dhe 3 që shfrytëzojnë tualetet e përbashkëta) dhe 8 dhoma me 2 paciente/dhome (nga këto 4 me tualete brenda dhe 4 që shfrytëzojnë tualetet e përbashkëta).

Në projekt janë parashikuar ambiente ngrënie të përbashkëta për të gjithë pacientet, gjithashtu vendosjen e një kuzhine të vogël për tu përdorur nga pacientet nën mbikëqyrjen e stafit si pjesë e rehabilitimit të tyre dhe përfshirjes në jetën e përditshme. Në çdo kat do të vendoset edhe një ambient rekreativ ku pacientet do të argëtohen në ambient të mbyllur. Gjithashtu rekreacioni sigurohet edhe në hapësirën e gjelbër pas objektit. Në projektimin e godinës garantohej lëvizja për PAK. Gjithashtu do të parashikohet një HS për PAK. Në ekstremitetet e vullmit ndërtimor do të vendosen shkallët e emergjencës për evakuim. Lëvizja vertikale do të kryhet nëpërmjet një korpusi shkalle ashensor në hyrje të godinës, i shkëputur nga korridori i klinikës.

Hapësirat e Brendshme :

Dizajni i dhomës: Dhomat private për pacientët do të sigurojë pacientëve ndjenjë autonomie dhe privatësie. Çdo dhomë është e projektuar me norma sigurie, me pajisje anti-ligaturë dhe mobileje për të parandaluar vetëdëmtimin. Përfshini elementë qetësues si ngjyrat neutrale, shtratin e rehatshëm dhe hapësirën personale të depozitimit.

Zonat e përbashkëta: Do të krijohen hapësira të përbashkëta ftuese dhe komode ku banorët mund të shoqërohen, të marrin pjesë në terapi grupore ose të përfshihen në aktivitete rekreative, si dhe përfshirjen e elementeve natyrore si bimët një zonë kopshti. Përfshini hapësira për ngrënie, relaksim dhe aktivitete të tilla si terapi arti ose joga.

Masa sigurie: I gjithë objekti, duke përfshirë zonat e përbashkëta, është projektuar duke pasur parasysh sigurinë për të parandaluar dëmtimin e banorëve ose stafit. Instalimi i sistemeve të sigurisë dhe kamerat e vëzhgimit në zonat e duhura.

Hapësirat terapeutike: Dhoma e terapive që do të jenë private dhe të favorshme për seancat e terapisë individuale ose në grup. Përfshini hapësira për këshillim, grupe mbështetëse dhe aktivitete të tjera terapeutike, gjithashtu duke përdorur teknika të izolimit të zërit për të siguruar privatësinë gjatë bisedave të ndjeshme.

Aksesueshmëria dhe lëvizshmëria: Zonat e objektit të jenë të aksesueshme për banorët me aftësi të kufizuara (P.A.K). Përfshi rampat, ashensorët dhe detajet në përputhje me PAK në të gjithë strukturën.

Hapësirat e jashtme terapeutike janë parashikuar për banorët që të pushojnë, të ushtrohen ose të përfshihen në aktivitete terapeutike duke përshtatur kopshtet, shtigjet e ecjes ose zonat e ndenjës për meditim dhe reflektim. Objektet mjekësore dhe trajtimi: Përfshini hapësira për ekzaminime mjekësore, konsultime dhe dhoma trajtimi, këto zona që të jenë mikpritëse dhe jo frikësuese, duke reduktuar paragjykimet që shpesh lidhet me vizitat mjekësore.

Mjedisi shërues: Përfshin elementë që do të nxisin një ndjenjë qetësie dhe mirëqenieje, si drita natyrale, vepra arti dhe orendi komode, dizajn me synimin për të reduktuar stresin dhe ankthin për banorët.

Godina Ekzistuese. Ndërtesa kryesore e Spitalit Psikatrik "Sadik Dinçi" Elbasan është e organizuar në katër kate. Sipërfaqja totale e spitalit është 13182m², nga te cilat sipërfaqja vetëm e objektit është 3445m², shesh 6717m² dhe rruge e lulishte pushimi 3020m².

- Kati nëntokësor me sipërfaqe rreth 600 m² përdoret për funksione teknike si kaldaja për prodhimin e ujit sanitar, lavanteria dhe magazinat e spitalit. Ky kat do të ruaje këto funksione por do të rikonstruktivet totalisht si në aspektin e instalimeve të nevojshme ashtu edhe në strukturën ndërtimore dhe detajet arkitektonike.

- Kati përdhe aktualisht përdoret për zyrat e administratës, farmacia, klinika e pranimit, pavijoni nr.1 dhe pavijoni nr.3. Gjithashtu në katin përdhe ndodhet dhe sala e kaldajave.

Gjendja ekzistuese – kati përdhe, ky kat do të ristrukturohet nga ana funksionale dhe ndërtimore. Administrata do të largohet nga kjo godinë duke u vendosur në një godinë të re duke lejuar organizimin e klinikes së pranimit në boshtin qendror të katit përdhe.

Në krahët anësore të godinës do të jetë një riorganizim hapësinor për të rishpërndarë pacientet në dhoma me 2 ose 4 banorë. Ne këto pjesë do të vendosen klinikat kronike.

Klinika e pranimit në hollin qendror ku ndodhet dhe hyrja kryesore në objekt shtohet një ashensor për lëvizjen e stafit dhe vizitoreve. Në dy këndet anësore në jug do të vendosen dhe dy ashensorë specifikë për spitale ku behet lëvizja e pacienteve në çdo kusht shëndetësor. Korpusit të shkalleve i shtohet dhe një dalje emergjence, në dy krahët anësore të volumnit vendosen pavijonet 1 dhe 3 me klinika kronike për meshkuj. Shpërndarja funksionale është e njëjte për të dy pavijonet.

Pavijoni përfshin 5 dhoma me 4 banorë dhe 8 dhoma me 2 banorë, pra 36 paciente në total. Në pavijon kemi dhe ambientin e argëtimit dhe sallën e ngrënies, duze dhe wc për pacientet dhe stafin në pozicione të ndryshme. Në çdo pavijon do të jenë zyrat e mjekut psiko-social, kryeinfermierit dhe infermiereve.

- Kati i parë me sipërfaqe 2516m² aktualisht përdoret për pavijonet e spitalit si pavijoni nr.5, pavijoni nr.6, pavijoni nr.4 dhe pavijoni nr.7. Edhe ky kat do të ristrukturohet nga ana funksionale dhe ndërtimore. Në krahët anësore të godinës do të ketë një riorganizim hapësinor për të rishpërndarë pacientet në dhoma me 2 ose 4 banorë. Në këto pjesë do të vendosen

klinikat kronike. Kjo zgjidhje do të kërkojë ndërhyrje strukturore për konsolidimin e mureve mbajtës që e përbejnë atë. Në boshtin qendror do të vendoset klinika akute për pacientet femra.

- Projekti ka parashikuar se në katin e parë në dy krahët anësore të volumit njësoj si në katin përdhe vendosen pavijonet me klinika kronike për meshkuj. Shpërndarja funksionale është e njëjte për të dy pavijonet. Struktura aktuale ka një ndarje me korridor rreth 3 m dhe një bateri dhomash me gjerësi 8.3 m ku akomodohen 8-10 banore. Dhomat e reja janë parashikuar për akomodimin deri në 4 banore.

Pavijonet përfshijnë 5 dhoma me 4 banore dhe 8 dhoma me 2 banore, pra 36 paciente ne total për secilin prej tyre. Ne pavijon do të jetë ambienti i argëtimit dhe salla e ngrënies.

- Kati i dytë aktualisht me sipërfaqe 604m² ku ndodhet pavijoni nr.2. do të ristrukturohet nga ana funksionale dhe ndërtimore. Në pjesën qendrore do te vendoset klinika akute për pacientet meshkuj. Kjo pjesë do ketë dy shtesa anësore që të lidhin kliniken me shkallët anësore dhe ashensorët që të lehtësojnë lëvizjen dhe gjithashtu të garantojë evakuimin ne rast zjarri.

- Godina do te parashikojë te gjitha kërkesat për MNZ dhe lëvizjen e PAK.

Fondi për mobilimin

Fondi për mobilimin sipas projekt buxhetit është parashikuar ne vlerën 34,000,000 leke.

Nevojat për shtesë në organike

Godina e re për gra me 2 klinika të reja sipas projektit do të kërkojë në vijim **shtese stafi në organikë me 34 punonjës** sipas nevojave për mjek, infermier, kujdestare, sanitare, kjo rritje e numrit të punonjësve dhe ulja e numrit të pacienteve në dhoma nga 8-10 në 2-4 do të ndikojë në rritjen e standardit të punës pasi, nga klinika me **60 pacientë do të kalohe në klinika me 36 paciente** dhe ngarkesa e punës së stafit shkon drejt standardëve të OBSH² për këto spitale.

Situata aktuale e Spitalit.

Spitali Psikiatrik “Dr. Sadik Dinçi” Elbasan ofron shërbime mjekësore për qytetarët e qarqeve Elbasan, Durrës, Korçë dhe për Bashkinë Lushnjë në 8 pavione me kapacitet 310 shtretër. Ky institucion ka për mision trajtimin e barabartë dhe pa diskriminim të personave me çrregullime të shëndetit mendor, ofrimin e kujdesit për personat me çrregullime të shëndetit mendor nga ekiye multidisciplinare.

Avokati i Popullit ndër vite ka ngritur shqetësimin se kushtet e jetesës në të cilat janë të akomoduar pacientët me çrregullime të shëndetit mendor në Shqipëri, vazhdojnë të jenë të rënda dhe të papranueshme, konstatim ky i përsëritur ndër vite po ashtu **edhe gjatë vizitës inspektuese të datës 24.04.2025**, në Spitalin Psikiatrik Sadik Dinçi Elbasan.

² <https://www.hphnet.org/wp-content/uploads/2024/01/Albanian-2020-HPH-Standards.pdf>

Ka një nevojë urgjente për përmirësimin imediat të kushteve e të shërbimit në Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” në Elbasan. Kushtet infrastrukturore luajnë rol të rëndësishëm për mirëqenien e të sëmurëve me çrregullime të shëndetit mendor dhe gjejmë rastin të shprehim vlerësimin për fillimin e proceduarve për rikonstruksionin e Godinave të Spitalit Psikiatrik Elbasan, për dhënien e zgjidhjes përfundimtare të këtyre problematikave.

Sistemi i ankimit ishte në funksion edhe në rastin e kërkesave/ankesave nga grupe interesi si shoqata apo grupime të tjera vullnetare të pacientëve, familjarë ose persona të interesuar për mbrojtjen e interesave të personave me çrregullime të shëndetit mendor. Drejtuesit e institucionit na informuan se kishin pasur një ankesë e cila ishte ndjekur dhe në rrugë zyrtare.

Struktura dhe organika e miratuar me Urdhër nr.401, datë 25.07.2024 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për “*Miratimin e Organikës së Spitalit Psikiatrik Elbasan*” institucionit është e përbërë nga 196 punonjës, prej të cilëve:

Përkatësisht Shërbimet Mjekësore:

Klinika e sëmundjeve Akute- 1 përgjegjës klinike(mjek psikiatër) dhe 2 mjek psikiatër;

Klinika e sëmundjeve Akute Meshkuj- 2 kryeinfermier, 12 infermier dhe 10 kujdestar;

Klinika e sëmundjeve Akute Femra- 1 kryeinfermier, 5 infermier, 5 kujdestar;

Klinika e sëmundjeve Kronike- mjek psikiatër 2;

Klinika e sëmundjeve Kronike Meshkuj- 2 kryeinfermier, 13 infermier,11 kujdestar;

Klinika e sëmundjeve Kronike Femra- 2 kryeinfermier, 12 infermier, 9 kujdestar;

Kabineti i Riaftësimit- 5 psikolog, 3 punonjës social, 4 kujdestar;

Kabineti Stomatologjik- 1 mjek stomatolog;

Farmacia- 1 përgjegjës farmacie dhe 1 farmacist;

Klinika e pranimit- 1 kryeinfermier, 5 infermier, 4 kujdestar, 1 infermiere (higjeniste), 1 infermier (për EKG /mikrokirurgjie), 1 fizioterapist;

Shtëpia e mbështetur “Drita” -2 infermier dhe 2 kujdestar;

Shtëpia e Mbrojtur “Jeta” Cërrik- 1 kryeinfermier, 4 infermier, 2 kujdestar.

Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor:1 përgjegjës i qendrës /njësisë (mjek psikiatër), 2 mjek psikiatër , 2 punonjës social, 2 psikolog, 4 infermier;

Pacientët e shtruar të ndarë në klinika, akut, subakut dhe kronik sipas datës së inspektimit 24.04.2025 si më poshtë :

- Klinika e pranimit: pacientë akut 5 burra / kapaciteti 8 persona,
- Klinika I: pacientë kronik, 57 burra/ kapaciteti 60 persona,
- Klinika II: pacientë kronik, 57 burra/ kapaciteti 60 persona,
- Klinika III: pacientë kronik, 41 gra/ kapaciteti 45 persona,
- Klinika IV: pacientë subakut, 37 gra / kapaciteti 45 persona ,
- Klinika V: pacientë akut, 29 burra/ kapaciteti 29 persona,
- Klinika VI: pacientë akut, 19 gra / kapaciteti 29 persona,
- Klinika VII: pacientë subakut 55 burra/ kapaciteti 55 persona.

Puna e shërbimit psikosocial ndahej sipas pavijoneve. Psikologu kryente vlerësimin e funksionimit psikologjik dhe mendor, si pjesë e vlerësimit multidisiplinar, që i bëhet pacientit pas kontaktit të parë në shërbim. Vlerësimi mund të bëhej në bazë të intervistës së strukturuar klinike ose duke përdorur teste të standardizuara të aftësive mendore dhe ose psikologjike. Stafi psiko-social pasi bënte një vlerësim psikologjik fillestar të cilin e pasqyronte në kartelën mjekësore të pacientit, bënte edhe ndjekjen e ecurisë së tij paralelisht me trajtimin terapeutik okupacional. Përgjatë inspektimit konstatuam se mundësitë terapeutike për këta persona ishin të reduktuara në sallat në ambientet e brendshme të spitalit dhe dy qendrat ditore “Rilindja” për gra dhe “Tulipan”³ për gra dhe burra, të ndodhura brenda territorit të spitalit. Aty zhvilloheshin aktivitete të ndryshme si vizatime, piktura dhe argëtime me muzikë.

Takimet me familjarët kryheshin në ambientet të brendshme të spitalit në çdo kohë dhe pa limit.

Konteksti dhe kuadri ligjor e institucional

Shërbimi shëndetësor në Shqipëri është rregulluar me ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton parimet kryesore dhe kuadrin ligjor për rregullimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë. Ndërkohë që shërbimi i shëndetit mendor në Shqipëri është rregulluar me ligj të posaçëm që në vitin 1996, përkatësisht me ligjin nr. 8092, datë 21.03.1996, “Për shëndetin mendor”, i cili më pas u shfuqizua me ligjin nr. 44/2012

³ Qendra Rilindja dhe Tulipan shërbejnë si qendra rekreacioni ditore nga ora 08:00-16:00, ku secila klinikë dërgon me rekomandimin e ekipit multidisiplinar një numër të caktuar pacientesh për të ndjekur terapitë okupacionale.

“Për shëndetin mendor”, i ndryshuar, që synonte përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e kësaj kategorie. Ky ligj solli nevojën e reformave në lidhje me ngritjen dhe zhvillimin në shkallë kombëtare të kujdesit komunitar të shëndetit mendor si e vetmja mënyrë për të arritur shërbime komunitare të shëndetit mendor për të gjithë (përfshi deinstitutionalizimin e personave që vuajnë sëmundje të shëndetit mendor, monitorimin e të drejtave dhe lirive themelore nga mekanizma të jashtëm, pjesëmarrjen aktive të aktorëve të shoqërisë civile, etj).

Në konceptin gjithëpërfshirës, kuadri ligjor dhe institucional ofron mundësinë e një sistemi të integruar të shërbimeve të shëndetit mendor, i cili nënkupton një rrjet shërbimesh në nivel rajonal.

Gjetjet e evidentuara përgjatë inspektimit

Në ditën e inspektimit në këtë shërbim me shtretër me kapacitet zyrtar prej 310 personash, gjendja e godinës vazhdonte të ishte tejet e rënduar duke i bërë kushtet të papërshtatshme dhe shume të vështira për këtë kategori pacientësh.

Në momentin e vizitës monitoruese trajtoheshin 298 pacientë të shtruar, nga të cilët 97 gra dhe 201 burra. Megjithëse në dukje nuk jemi në kushtet e mbipopullimit, akomodimi dhe qëndrimi i **10-12 pacientëve në një dhomë sillte mosrespektim të hapësirave jetike**, kusht ky i domosdoshëm për trajtimin njerëzor apo të përshtatshëm të pacientëve në institucione psikiatrike.

Komiteti për Parandalimin e Torturës në Këshillin e Evropës (KPT) ndër vite ka ngritur shqetësimin se pacientët me çrregullime të shëndetit mendor në Shqipëri vazhdojnë të mbahen në kushte të papranueshme dhe gjatë vizitës së tij në Shqipëri në vitin 2018, në raportin me rekomandime drejtuar Qeverisë Shqiptare⁴ ka nënvizuar që kapacitet e mëdha në akomodim të shndërrohen në struktura të bazuara në grupe më të vogla (d.m.th. jo më shumë se katër shtretër në një dhomë me hapësira të personalizuar, përfshirë vendet për sendet personale).

Komiteti për Parandalimin e Torturës në Këshillin e Evropës (KPT) gjatë vizitës së tij në Shqipëri në vitin 2018, në raportin me rekomandime drejtuar Qeverisë Shqiptare⁵, ka theksuar se: *“Për sa i përket kushteve të jetesës së pacientëve në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka planifikuar në vitet e ardhshme rindërtimin e Spitalit Psikiatrik të Elbasanit bazuar dhe në rekomandimet e Delegacionit për kushtet e jetesës të cilat do të zbatohen në projektin e rindërtimit”*.

Rekomandimi i KPT-së për këtë çështje, është i pazbatuar deri në muajin Prill 2025.

⁴ CPT Report 2019, <https://rm.coe.int/16809cb571>

⁵ CPT Report 2019, <https://rm.coe.int/16809cb571>

KPT ndër vite ka ngritur shqetësimin se pacientët me çrregullime të shëndetit mendor në Shqipëri vazhdojnë të mbahen në kushte të papranueshme. Në fakt, kushtet e jetesës në këtë institucion ishin përkeqësuar më tej dhe niveli i kujdesit psikiatrik mbetet qartë i pamjaftueshëm. Në përgjithësi, Komiteti krijoi përshtypjen e “braktisjes terapeutike” të shumë pacientëve.

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit personat me çrregullime të shëndetit mendor e kanë domosdoshmëri trajtimin nga mjeku specialist psikiatër dhe nga ekipi multidisciplinar. Kësaj i shtohet edhe fakti që në vite nuk ka patur një përmirësim të qenësishëm në rritjen e numrit të stafit mjekësor, megjithë rekomandimet e Avokatit të Popullit, **si dhe situata e braktisjes terapeutike e konstatuar edhe përgjatë inspektimit, ende nuk ka ndryshuar.**

Në ditën e vizitës, kushtet materiale paraqiteshin tejet të përkeqësuar, dhomat ishin të pajisura me deri në dymbëdhjetë shtretër secila, akomodimi në kushte të depersonalizuara (vetëm krevata pa mobilje), Pajisjet sanitare në tualetet e pavijoneve ishin të dëmtuara dhe nuk ishin të përshtatura edhe për nevojat e pacientëve me aftësi të kufizuara fizike.

Në 7 (pavionet e spitalit) ku ishin të akomoduar pacientët, dhomat kishin ndriçim natyror por muret ishin të pa lyera dhe me lagështirë gjithashtu kishin mungesë të theksuar higjiene si dhe kishte ajër tepër të rënduar, në dhomat e shtrimit akomodohen nga 10-12 persona.

Tualetet dhe dushet në të gjitha pavijonet ishin tërësisht të amortizuar me lagështirë të theksuar muret me myk e të palyera, suva të rëna si dhe një mungesë higjiene të theksuar.

Grupi inspektues bëri takime private, pa praninë e personelit të shërbimit me **personat me masë mjekësore “mjekim i detyruar”**, ata nuk shprehën ankesa për keqtrajtim fizik apo ushtrim dhune nga personeli i këtij spitali.

Përgjatë inspektimit konstatuam se vijonte të **mungonte laboratorit klinik-biokimik** krijonte një problematikë të shtuar në diagnostikimin dhe më tej në terapitë e këtyre pacientëve. Analizat për pacientet e këtij shërbimi, vazhdon të kryhej në Spitalin Rajonal Elbasan.

Furnizimi me produkte higjiene-sanitare dhe pajisje të tjera individuale, është realizuar nëpërmjet një kontrate shërbimi dhe nuk ka pasur mungesa, **por në vlerësimin tonë ato ishin të pamjaftueshme për numrin e lartë të pacientëve të akomoduar në spital.**

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguruar, ndërsa **ngrohja dhe ftohja e ambienteve mungonte totalisht.**

Përsa i përket ushqimit, ai sigurohej me kontraktim të një shoqërie private e cila përfshinte përgatitjen dhe servirjen e ushqimit të pacientit, në bazë të sëmundshmërisë. Dieta, për pacientë me dietë speciale apo pacientët diabetik përcaktohej nga mjeku. Kuzhina ishte e pastër, sistemi i aspirimit ishte funksional, menyuja javore ishte e afishuar si dhe kuzhinierët

dhe punonjësit që shpërndanin ushqimin, ishin të pajisur me librezën shëndetësore të higjienës. Kampionet ushqimore ruheshin rregullisht në kushte frigoriferike.

Furnizimi me medikamente ishte kryer rregullisht dhe **nuk** kishte patur mungesa për vitin 2025.

Ambientet e përbashkëta dhe korridoret nuk ishin të monitoruara me sistemin audio-viziv. Kishte vetëm 4 kamera të vendosura në hyrje të spitalit dhe në korridorin e katit të parë të administratës me afat ruajtje 30-ditore. Mungesa e një sistemi monitorues vëzhgimi në të gjitha ambientet e këtij institucioni, cenon ruajtjen dhe parandalimin nga vepra të dhunshme ndaj pacientëve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Spitali nuk kishte prej 6 vitesh ambulancë, pasi ajo që ka qenë është jashtë funksionit. Nga ana e spitalit janë bërë kërkesa të vazhdueshme për pajisje me autoambulancë në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore dhe MSHMS.

Shtrime të pavullnetshme aktualisht kishte gjendje të rripave kufizues, por kishte mungesa për këmisha force, kjo mungesë e vështirëson trajtimin e rasteve emergjente në këtë spital. Avokati i Popullit vlerëson se vulnerabiliteti i theksuar i këtyre personave kërkon vëmendje të Institucioneve.

Shërbimi dentar Gjatë këtij viti ishte bërë shërbimi në kabinet për 25-pacientë, si dhe janë depistuar 122 pacientë. Problematikat në këtë shërbim ishin në: Pajisje jashtë funksionit, mungesë e theksuar e materialeve për të përmbushur nevojat e pacientëve.

Ligji për shëndetin mendor, në nenin 31 të tij, përcakton procedurat e monitorimit të jashtëm të shërbimit të shëndetit mendor nga Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit Çnjerëzor dhe Poshtërues, që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij. Ligji garanton vëzhgimin e rregullt me anë të inspektimeve periodike, për të respektuar të drejtat dhe standardet që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, si dhe paraqet rekomandime në organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të pacientëve dhe sigurimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut në institucionet e kujdesit të shëndetit mendor.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave nga ana e Spitalit Psikiatrik Elbasan për informimin e Avokatit të Popullit, për kohën e fillimit të punimeve për rikonstruksionin të godinës së Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi”, në Elbasan.
2. Marrjen e masave për realizimin e projektit të rikonstruksionit sipas standardeve të përcaktuara nga KPT ku dhomat të jenë jo më shumë se për 4 pacientë dhe të sigurohen hapësira të personalizuar, përfshirë dollapë/komodina për sendet personale.
3. Marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për pajisjen me Autoambulancë brenda vitit 2025.
4. Marrjen e masave për shtimin e organikës me 34 punonjës si mjek, infermier, sanitarë etj, lidhur me nevojën e mbështetjes me staf të godinës së re për gra me 2 klinika të reja.
5. Marrjen e masave për zgjidhjen e problemit të trajtimit si rezidentë të personave me aftësi të kufizuara intelektuale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndrysh

**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e
Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose
poshtërues (MKPT)**

KOMISIONER

AHMET PRENÇI

d.v